

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 6 TETOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Meqenëse këtu u ngrit çështja e pedagogëve, dua të them dy fjalë për të, si dhe të jap disa argumente plus edhe për fjalën që mbajta dje pas mbledhjes së qeverisë. Në fakt, çështjen e pedagogëve, kërkesat e tyre ne i kemi në vëmendje tashmë prej kohësh. Edhe në mbledhjen e përmuajshme që bëjmë me Komitetin e Politikave për Arsimin e Lartë, edhe në takime me pedagogë, edhe në takime me përfaqësues të sindikatave, madje edhe çështjen e pagave të pedagogëve, ashtu si shumë çështje të tjera që ata kanë ngritur në kërkesat e tyre, i kemi diskutuar në mënyrë të vazhdueshme me ta.

Pikërisht, falë këtij dialogu, falë paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, inflacionit të luftës, por edhe duke e integruar me politikën tonë për të financuar universitetet sipas performancës, dje në mbledhjen e Këshillit të Ministrave kemi vendosur që pagat e pedagogëve të rriten deri në 15%, ku 7% do të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe mbi këtë nivel universitetet vetë me autonominë e tyre mund të vendosin t'i rrisin pagat nga 8%, 9%,10% deri në 15%, në varësi të të ardhurave që grumbullojnë, në varësi të performancës së tyre. Kjo mbështetje është vetëm një hap. Sigurisht që ne nuk do të ndalemi këtu, edhe për çështjen e pagave, por edhe për çështje të tjera. Vitin e ardhshëm përsëri mund të kemi një rritje tjetër. Ndërkohë, duhet të theksojmë që ligji i arsimit të lartë u jep mundësi universiteteve që pedagogët të rrisin të ardhurat jo vetëm me buxhetin e shtetit.

Ç'u pa pastaj, që flasim për autonomi të universiteteve në qoftë se universitetet varen 100% nga buxheti i shtetit! Universitetet i kanë të gjitha mundësitë, që të krijojnë të ardhura, të cilat pedagogët mund t'i përdorin edhe për rritjen e pagave të tyre, përveçse t'i përdorin për funksione dhe objektiva të tjerë. Natyrisht, pedagogët mund të përfitojnë nga angazhimi i tyre

më i madh në kërkimin shkencor. Unë mund t'ju jap shifrat për financimin që qeveria shqiptare i ka bërë kërkimit shkencor. Janë rritur, gati dyfishuar, vetëm projektet e kërkim-zhvillimit, projekte nga të cilët përfitojnë drejtpërdrejtë pedagogët.

Përveç infrastrukturës së kërkimit shkencor, projektet e kërkim-zhvillimit nga Agjencia Shqiptare për Kërkimin dhe Inovacionin, janë financime që shkojnë drejtpërdrejtë te pedagogët. Në fakt, është rritur dhe është shumëfishuar numri i pedagogëve që aplikojnë me projektet e tyre te kjo Agjenci dhe përfitojnë. Të gjitha universitetet janë angazhuar, madje jo vetëm universitetet shtetërore, por edhe ato private. Nga ana tjetër, programi i Bashkimit Europian, Horizont Europa, ka një rritje të ndjeshme të aplikimeve për projekte nga universitetet shqiptare, si dhe një rritje të suksesit të këtyre universiteteve. Këto aplikime janë rritur nga 8% në 38%. Pra, po të krahasojmë programin Horizont Europa me Programin 2020, diferenca është shumë e madhe. Vetëm këtë vit, në 2022, universitetet shqiptare kanë përthithur 2,1 milionë euro.

Po ku shkojnë këto para? Natyrisht që një pjesë e tyre shkojnë te pedagogët, të ardhura për ta, falë punës dhe performancës së tyre. Ka raste kur të ardhurat e pedagogëve që marrin përtej pagës, janë shumë herë më të mëdha se paga. Universitetet dhe pedagogët i kanë të gjitha mundësitë, t'i rrisin të ardhurat e tyre dhe të mos varen vetëm nga paga mujore. U tha këtu se duhet të rrisim pagat e pedagogëve, që ata të mos emigrojnë. Po pedagogët sot më shumë se kurrë kanë arsye që të mos emigrojnë, falë ndërkombëtarizmit të universiteteve, ashtu siç po përfitojnë studentët nëpërmjet programeve të përbashkëta dhe programeve të dyfishta. Familjet shqiptare sot nuk kanë nevojë t'i dërgojnë fëmijët jashtë vendit për të studiuar në universitete me cilësi më të lartë edukimi, sepse vetë universitetet prestigjioze po vijnë këtu, dhe në fund fare, diploma që do të marrin këta studentë ka të njëjtën vlerë me diplomat e bashkëmoshatarëve të tyre në Bashkimin Europian.

Në të gjitha universitetet është rritur numri i programeve të përbashkëta dhe të dyfishta, që në fund i jep vlerë diplomës, jo vetëm cilësi arsimit. Në të njëjtën mënyrë mund të përfitojnë edhe pedagogët. Ky ishte viti i parë që qeveria shqiptare dha buxhet të dedikuar vetëm për ndërkombëtarizimin, pikërisht për këto programe të dyfishta dhe programe të përbashkëta.

Janë pedagogët ata që përfitojnë nëpërmjet shkëmbimeve, nëpërmjet projekteve dhe nëpërmjet mësimdhënies. Kështu që e përsëri edhe një herë: mbështetja jonë për pedagogët padyshim do të vazhdojë, mbështetja jonë për universitetet do të vazhdojë dhe jo vetëm në drejtim të pagave, por edhe në mbështetje të kërkimit shkencor, edhe duke rishikuar udhëzimet për shpërndarjen e ngarkesës mësimore të pedagogut, për veprimtarinë e tyre dhe për procedurën e pagesës së orëve suplementare.

Të mos harrojmë, pedagogët paguhen edhe për orët suplementare. Pra, pedagogët sot, ata që janë të angazhuar, ata që punojnë, ata që i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë, natyrisht kanë mundësi të kenë të ardhura shumë herë më të larta se paga që garantohet nëpërmjet buxhetit të shtetit me grantin e pakushtëzuar. Faleminderit!